



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA E PERMBARIMIT KORCE

Nr. 311 prot.

Korcë, më 06.02.2020

L e n d a: Shpallje per shitje e sendit te paluajtshem ne ankandin e dyte

Drejtuar: (debitorit) z.Andrea Demollari banues ne Maliq,Korce perfaqesuar me prokure nga av.Andia Bonja

(kreditorit):znj.Dhurata Kalari perfaqesuar me prokure nga znj.Elviqe Lami banuese ne Lagjen nr.10,Rr.Blloku i Ri i Sportit.Rr."Studenti",pallati perballe konviktit te universitetit

Bashkise Maliq
Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce
Drejtorese Pergjithshme Permbarimit Tirane
Gazetes Panorama dhe Gazetes Shqiptare

Bashkelidhur po ju dergojme per njoftim dhe afishim sipas ligjit Vendimin nr.31 prot date 06.02.2020 per shpalljen e shitjes ne ankandin e dyte te pasurise se paluajtshme te llojit « Truall+Ndertese »me nr.pas.18/205,ZK.3553,VOL.9,FQ.163 me siperfaqe 150 m2 truall nga te cilat 150 m2 ndertese e ndodhur ne Symiz,ish NB Maliq,me ane te se cilit njoftojme se ne date 09.03.2020 ditën e Hene,ora 16.00 ne ambjentet e Zyres se Permbarimit Korce,perfundon ankandi i dyte ,i cili eshte shpallur me date 06/02/2020,per shitjen e sendit te paluajtshem te debitorit Andrea Demollari banues ne Maliq,Korce,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit znj.Dhurata Kalari.

Faleminderit per bashkepunimin Tuaj



-D. Daj. Publi
dt. 10.02.2020
[Signature]

Nr. 22 prot
dt. 11.02.2020

Adresa:Lagjia nr.7,Rr."28 Nentori"nr.1,ish-Bashkia.Korce

Tel/fax.082245621



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA E PERMBARIMIT KORCE

Nr.31 prot.

Korcë, më 06.02.2020

V E N D I M

(PER SHPALLJEN E SHITJES NE ANKAND TE DYTE TE PASURISE SE PALUAJTSHME)

Une **Olta Shkambi** Permbaruese Gjqesor prane Zyres Permbarimore Korce,pasi studiova materialet e dosjes permbarimore nr.990-011 date 08/11/2011 bazuar ne "Urdherin e Ekzekutimit" nr.410 date 14/06/2011 te Gjykates Rrethit Gjqesor Korce.

K O N S T A T O V A :

Se ne datat 08/11/2011 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit Korce, kerkesa e (kreditorit) Dhurata Kalari banuese ne Korce se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te titullit ekzekutiv vendimit gjqesor nr.965,date 18.04.2011 te Gjykates Rrethi Gjqesor Korce ndryshuar pjeserisht me vendimin gjqesor nr.466 date 18.04.2019 te Gjykates Rrethi Gjqesor Korce me pale:

Kreditor : Dhurata Kalari

Debitor : Andrea Demollari

Me objekt :Pension ushqimor + shpenzime permbarimore ne shumen prej 1.599.818 leke

Lidhur me ekzekutimin e ketij vendimi kane filluar procedurat ligjore sipas neneve 517,519, 527, 560,568 e vijues te K.Pr.Civiledhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksionimin e Sherbimit Permbarimor Gjqesor.

Me urdherin nr.3012 prot, date 14.11.2018 eshte vendosur sekuestro konservative ne pasurine e paluajtshme :

-Llojit "Truall + Ndertese"me nr/pas.18/205,Z.K.3553,vol.9,fq.163 me siperfaqe prej 150 m2 truall nga te cilat 150m2 ndertese ,e ndodhur ne Symiz,Korce e regjistruar ne Z.V.R.P.P.Korce ne emer te shtetasit debitor Andrea Demollari.

Adresa:Lagjia nr.7,Rr."28 Nentori"nr.1,ish-Bashkia,Korce

Tel/fax.082245621

Me aktin teknik te ekspertimit eksperti vleresues z.Jani Stratoberdha ka percaktuar se vlera e pasurise se paluajtshme e llojit "Truall+Ndertese" nr/pas.18/205,Z.K.3553,vol.9,fq.163 me siperfaqe prej 150 m2 truall nga te cilat 150m2 ndertese ,e ndodhur ne Symiz,Korce,ish stallat e NB Maliq eshte 2.428.080 lek.

Me shkresen nr.565 prot date 24.09.2019 ne baze te nenit 567 te K.Pr.Civile,eshte lajmeruar debitori Andrea Demollari se nese brenda 10 diteve te njoftimit nuk do te permbushte detyrimin,sendi i sekuestruar do te shitet ne ankand.

Sipas akteve te administruara ne dosjen permbarimore,nuk rezulton te jete permbushur detyrimi nga debitori.

Ne date 06.11.2019 u shpall ankandi i pare per shitjen e sendit te sekuestruar.

Procedura e ankandit te pare vazhdoi 15 dite dhe perfundoi me mbarimin e orarit zyrtar ne date 21.11.2019.

Nga procedura e zhvillimit te ankandit te pare si dhe nga procesverbali i dates 21.11.2019 te zhvillimit te tij rezultoi se ne te gjithë afatin 15-ditor te mbajtjes se afishimit te shitjes se sendit te paluajtshem,ashtu si dhe ditën e zhvillimit te tij,nuk u paraqit asnje ofertues per blerjen e sendit te paluajtshem te percaktuar me nje cmim ne vleren 1,942,464 lek.

Ne date 20.11.2019 eshte depozituar nga ana e kreditorit vendimi gjyqesor nr.466 date 18.04.2019 i Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce lene ne fuqi me vendimin nr.330 date 31.10.2019 i Gjykates Apelit Korce me ane te se cilit eshte vendosur ndryshimi pjesisht i vendimit gjyqesor nr.965 date 18.04.2011 i Gjykates Rrethit Gjyqesor Korce duke u shtuar detyrimi ushqimor per femijen Stefanos Demollari nga 6.500 lek ne muaj ,ne shumen 20.000 lek ne muaj.

Ne zbatim te ketij vendimi eshte bere llogaritja e re e detyrimit , i cili sot me date 06.02.2020 rezulton te jete ne shumen prej 1.599.818lek(perfshire edhe shpenzimet permbarimore ne fazen e ekzekutimit).

Me vendimin nr.2039 prot,date 02.12.2019 u shpall ankandi i dyte per shitjen e pasurise se paluajtshme te sekuestruar,i cili nuk u zhvillua ne datën percaktuar pasi nuk u afishua ne dy gazetate kombetare me tirazh me te madh sic parashikon neni 568 i K.Pr.Civile.

Per keto arsye: ne baze te neneve 568,570 e 577 te K.Pr.Civile, ligjit 8730 date 18/ 01/ 2001" Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor" dhe udhezimit nr.5 date 12.12.2012 "Per percaktimin e rregullave te hollesishme per zhvillimin e ankandit nga permbaruesi gjyqesor, une permbaruese gjyqesore Olta Shkemb

V E N D O S A:

1-Shpalljen e shitjes ne ankand te dyte te pasurise,si me poshte:

Lloji "Truall + Ndertese" me nr.pasurie 18/205,Z.K.3553,vol.9,fq.163 me siperfaqe prej 150 m2 ,e ndodhur ne Symiz,Korce,ish NB Maliq ne pronesi te Andrea Pandeli Demollari.

Me kete shpallje njoftoj te gjithë te interesuarit,duke i

INFORMUAR SE

1-Cmimi fillestar ne ankandin e dyte te hapur publik eshte jo me i ulet se 30% (perqind) i cmimit te percaktuar ne ankandin e pare prej 1.942.464 lek – 582,739 lek = 1,359,725 lek .

2-Vendi ku do te zhvillohet ankandi i dyte i hapur publik i shitjes se sendit eshte Zyra e Permbarimit Korce,e cila gjendet ne adresen.Lagjia nr.7,Rr.”28 Nentori”nr.1,ish-Bashkia,Korce.

3) Ankandi i dyte i hapur publik per shitjen e sendit te paluajtshem shpallet sot me date 06.02.2020 dhe do te qendroje i publikuar deri ne date 09.03.2020,diten e Hene ora 16.00.

4)Dorezimi i kerkesave per pjesmarrje ne ankandin e hapur publik te pare do te pranohen ne te gjithë afatin e shpalljes dhe procesi perfundimtar i zhvillimit te ankandit do te kryhet ne date **09.03.2020** ditën e Hene duke u mbyllur ne oren **16.00** me mbarimin e orarit zyrtar.

5)Cdo ofertues qe eshte i interesuar per blerjen e pasurise ne ankand ,eshte i detyruar te paraqitet personalisht dhe/ose nepermjet perfaqesuesit te tij/saj me prokure,**si dhe te dorezoje (brenda ne zarf te mbyllur)ne zyren e permbarimit gjyqesor deri ne oren 16.00,keto dokumenta:**

- a) Kerkesen e tij/saj per pjesmarrje ne ankand
- b) Faturen bankare te 10% te garancise per pjesmarje ne ankand(ne original)
- c) Dokumentin e identifikimit(Karte identiteti ose Pasaporte)

6)Cdo ofertues qe merr pjese ne ankand,perpara fillimit te procedurave te shqyrtimit te ofertave ,ne datën **09.03.2020** ,ora **16.00**,eshte i detyruar te depozitoje si garanci prane Bankes “Credins”Korce ne nr.llogarie 153916 te Zyres Permbarimit Korce nje shume te hollash te barabarta me 10% te cmimit te pasurise te caktuar ne shpallje.Kreditori nuk le garanci,ne rast se kredia e tij e kalon masen e garancise.

7)Debitori dhe/ose perfaqesuesi i tij ligjor.permbaruesi gjyqesor,si edhe personat e tjere qe listohen ne nenin 709 te Kodit Civil,nuk kane te drejte te marrin pjese ne ankand.

8)Gazeta “Panorama” dhe Gazeta “Shqiptare”,sipas detyrimit qe rrjedh nga neni 568 i K.Pr.Civile,kete vendim detyrohen ta publikojne 5(pese) dite me rradhe,ne gazetate e tyre.Per sherbimin e kryer,pala kreditore merr persiper pagimin e shumes e cila me pas sipas nenit 525 te K.Pr.Civile i ngarkohet debitorit.

Ky vendim hartohet ne **10(dhjete)**kopje.1(Nje) kopje administrohet ne dosjen permbarimore **1(nje)** kopje afishohet ne ambientet e Zyres Permbarimit Korce **1(nje)** kopje afishohet ne vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme;**1(nje)** kopje i njoftohet debitorit dhe perfaqesuesit te tij ; **1(nje)**kopje i njoftohet kreditorit; **2(dy)**kopje ju njoftohen Gjykates Rrethi Gjyqesor Korce dhe Bashkise Maliq,per afishim ne ambientet e tyre publike,**1(nje)** kopje dergohet ne Drejtorine e Pergjithshme te Permbarimit ; si dhe **2(kopje)**iu njoftohen per publikim,Gazetes “Panorama” dhe Gazetes “Shqiptare”

KRYETARE
PERMBARUESE GJYQESORE
Olta Shkëmbi

Adresa:Lagjia nr.7,Rr.”28 Nentori”nr.1,ish-Bashkia,Korce

Tel/fax.082245621